



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport**

Mbledhja nr.83  
Prishtinë, më 4.7.2024, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204.

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ardian Gola, kryetar, Albena Reshitaj, Enis Kervan, Adriana Matoshi, Arjeta Fejza, Arijeta Rexhepi, Jahja Kokaj dhe Eliza Hoxha.

**Munguan:** Ardian Kastrati dhe Vlora Dumoshi.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi:** Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

**1. Intervistimi i kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;**

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

**1. Intervistimi i kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore**

**Ardian Gola**, tha se sikurse jeni në dijëni nga mbledhja e fundit ku kemi shqyrtuar aplikacionet e gjashtëmbëdhjetë kandidatëve që kanë aplikuar për anëtarë të KKTK-së, të gjithë kandidatët që kanë aplikuar i kanë plotësuar kriteret e konkursit, të njëjtit janë ftuar në intervistë dhe po ashtu, kanë konfirmuar pjesëmarrjen në intervistë.

Propozoi që poentimi i kandidatëve të bëhet bazuar në intervistën që do të realizohet me kandidatët duke pasur parasysh se përgatitja profesionale dhe përvoja e punës do të reflektoj edhe në përgjigjet e tyre gjatë intervistimit. Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që secilit kandidat t'i parashtrohen fillimisht nga tre pyetje e të cilat kanë të bëjnë me kompetencat e KKTK-së, identifikimin e sfidave në fushën e trashëgimisë kulturore si dhe vizionin e kandidatëve për të adresuar sfidave në fushën e trashëgimisë kulturore.

Po ashtu, anëtarët e Komisionit u pajtuan që pas procesit të intervistimit dhe vlerësimit të kandidatëve, të procedohet për seancë plenare rekomandimi për emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Komisioni filloi me intervistimin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, sipas numrit rendor që kanë aplikuar, koha e përcaktuar për intervistim për secilin kandidat është caktuar nga dhjetë minuta.

Komisioni pas përfundimit të intervistimit të kandidatëve, bazuar në renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra gjatë intervistimit, bëri përzgjedhjen e shtatë kandidatëve për anëtarë të KKTK-së, si në vijim:

1. Artan Krasniqi – 78.5 pikë,
2. Fahri Sheqiri – 74.5 pikë,
3. Besarta Reçica – 74.4 pikë,
4. Esin Salla – 74 pikë,
5. Zanita Halimi – 72.6 pikë,
6. Arianit Buçinca – 72 pikë,
7. Sllajana Boshkoviç – 59.5 pikë.

Anëtarët e Komisionit me shumicë votash, tetë (8) për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratuan listën e 7 (shtatë) kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, dhe Kuvendit i rekomandon për emërim.

Mbledhja përfundoi në orën 16:10

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Ardian Gola,

---

Kryetar i Komisionit